

VENDIM
Nr. 135, datë 2.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 688, DATË 14.11.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË OBJEKTIT, ME EMËRTIM “OBORR I QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE ‘NËNË TEREZA’, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” , të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 688, datë 14.11.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

a) Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) 25 (njëzet e pesë) % kalojnë në llogarinë e qendrës spitalore universitare ‘Nënë Tereza’, Tiranë, prej të cilave:

i. 3 (tre) % përdoren për edukimin në vazhdim të burimeve njerëzore të kësaj qendre;

ii. 22 (njëzet e dy) % përdoren për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera.”.

ii. Në shkronjën “b”, shifra “42%” zëvendësohet me “20%”.

b) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Të ardhurat e krijuara që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit dhe të papërdorura kalojnë 80% si të ardhura dytësore në buxhetin e QSUT-së për t’u përdorur për investime në infrastrukturë, pajisje mjekësore ose investime të tjera dhe 20% do të përdoren nga FSHZH-ja me kërkesë të QSUT-së dhe pas miratimit paraparak të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në infrastrukturë, për përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, në përmbushje të objektivave dhe të misionit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe qendra spitalore universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama